

BANKA E SHQIPËRISË

DEKLARATË PËR SHTYP

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2008

QERSHOR 2008

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2008

QERSHOR 2008

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të vitit 2008 rezultoi me një pakësim mjetesh valutore prej 25.7 milionë euro. Flukset hyrëse neto të kapitalit kanë përballuar rreth 73 për qind të deficitit korent.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Aktivitet tepër intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente.
- Thellim i deficitit korent dhe i atij tregtar.
- Rritje e detyrimeve financiare të vendit ndaj botës, e shprehur kryesisht në rritje të investimeve të huaja direkte dhe investimeve të tjera afatshkurtra.
- Rënie të rezervave valutore të autoritetit monetar.

I. LLOGARIA KORENTE

Tremujori i parë i vitit 2008 karakterizohet nga një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të konsiderueshme të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente. Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me rreth 12 për qind krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar dhe shënoi një nivel prej 1.8 miliardë eurosh.

Mëse 94 për qind e shpenzimeve korente kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh. Rreth 35 për qind e të ardhurave korente ka hyrë në formën e transfertave, ndërkohë që shërbimet dhe eksportet e mallrave siguruan përkatësisht 34 për qind dhe 23 për qind të të ardhurave në valutë të vendit. Deficiti korent, për këtë tremujor, u vlerësua 298.3 milionë euro, me një rritje prej rreth 1.6 herë kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2007.

Deficiti i lartë tregtar, që ka karakterizuar zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë gjatë këtij tremujori, ka neutralizuar efektin pozitiv të ngushtimit të deficitit të bilancit të llogarisë së shërbimeve dhe të të ardhurave faktoriale neto, duke mbetur shkaktari kryesor në thellimin e deficitit korent për këtë periudhë.

I. 1. TREGTIA E JASHTME

Fluksi i lartë i shkëmbime tregtare vazhdon të karakterizojë edhe fillimin e vitit 2008. Vëllimi i përgjithshëm tregtar këtë tremujor arriti afërsisht vlerën e 942 milionë eurove, duke u vlerësuar 17 për qind më i lartë se niveli i të njëjtës periudhës të vitit paraardhës.

Në terma relative, ritme të larta rritëse regjistrohen si për eksportet, ashtu edhe për importet, respektivisht 13 për qind dhe 18 për qind.

Defititi tregtar për këtë periudhë vlerësohet në 531 milionë euro ose 20 për qind më i lartë se në tremujorin e parë të vitit 2007.

Raporti i mbulimit të importeve nga eksportet mbetet në nivele të ulta (28 per qind), duke theksuar karakterin importues të tregtisë së jashtme si rezultat i kapacitetit të pamjaftueshëm të prodhimit vendas.

Të ardhurat nga eksportet në fund të tremujorit të parë të vitit 2008 kanë arritur shifrën 205 milionë euro duke rezultuar në një rritje në terma absolute prej 23 milionë euro (13 për qind) krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2007. Kjo rritje ka ardhur si pasoje e rritjes së të dy kategorive; eksportet nga përpunimi aktiv dhe eksportet e brendshme.

Industria përpunuese përbën pjesën dërrmuese të eksporteve të vendit tonë duke përfaqësuar 70 për qind të tij, ndërkohë që eksporti i prodhimit vendas zë vetëm 30 për qind. Megjithatë, gjatë këtij tremujori, niveli i përfaqësimit në totalin e eksporteve ka ndryshuar lehtësisht. Industria përpunuese ka pësuar një rënie prej 2 për qind në nivel përfaqësimi ndërkohë që eksporti i brendshëm është rritur me 2 për qind. Ky fenomen është tregues i rëndësishëm i përmirësimit të kapacitetit prodhues në vendin tonë.

Eksportet e industrisë përpunuese rezultojnë 10 për qind më të larta se viti paraardhës. Eksportet e përpunimit të tekstileve (të cilat zënë 44 për qind të industrisë përpunuese) ka pësuar një rritje prej 19 për qind krahasuar me të njëjten periudhë të vitit paraardhës. Gjithashtu, eksportet e metaleve bazë janë rritur me 9 për qind gjatë këtij tremujori. Nga ana tjetër, industria e këpucëve, edhe pse një ndër sektorët kryesorë të përpunimit aktiv, ka pësuar rënie me 10 për qind.

Nga ana tjetër, eksporti i brendshëm i vendit tonë ka pësuar një rritje prej 20 për qind krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2007. Peshën më të madhe të eksportit të brendshëm e zënë grupmallrat e produkteve minerale dhe metalet bazë respektivisht me 34.6 dhe 35.5 për qind. Produktet minerale janë rritur me 3 për qind ndërkohë që vihet re një rritje e ndjeshme e eksporteve të metaleve bazë me 73 për qind.

Në krahun e importeve, të dhënat tregojnë për zhvillime pozitive dhe zgjerim të mëtejshëm të produkteve kryesore të importura. Vendi ynë shpenzoi afërsisht 737 milionë euro për blerje mallrash.

Importet kryesore të vendit tonë përfaqësohen nga importet e industrisë përpunuese, të ushqimeve dhe pijeve, të lëndës parë bujqësore, të naftës dhe metaleve duke u vlerësuar 62 për qind e totalit të importeve gjatë tremujorit të parë të vitit 2008.

Industria përpunuese në vend zë 26.7 për qind të importeve për tremujorin e parë të vitit 2008 dhe u vlerësua me një rritje në villim prej 4.3 për qind.

Produktet ushqimore janë rritur prej rreth 21 milionë euro në vlerë absolute (26 për qind) duke përfaqësuar 13 për qind të totalit të importeve të vendit tonë. Ndërkohe, produktet e pijes janë rritur me ritme më të ulëta së viti i mëparshëm, një rritje e vlerësuar vetëm 18 për qind krahasua me vitin paraardhës nga 48 për qind në vitin 2007 krahasuar me 2006.

Shumë premtuese janë zhvillimet pozitive të importeve në makineri dhe pajisje (grupmall ky që përfaqëson 16.2 për qind të importit të përgjithshëm), tregues i rritjes së nivelit të investimeve në vend. Këtë tremujor këto importe janë rritur 22 për qind krahasuar me vitin paraardhës. Gjithashtu, kategoria e produkteve minerale është rritur me 11.1 për qind këto tremujor. Ndërkohë, megjithëse me një përfaqësim relativisht të ulët (prej 7 për qind), ritmet e larta të rritjes rreth 37 për qind të produkteve vegjetale kanë kontribuar në rritjen e importeve të vendit tonë.

Metalet bazë kanë pësuar një rënie prej rreth 10 për qind duke i reduktuar importet e metaleve në 51 milione euro nga rreth 55 milione euro vlerësuar në tremujorin e parë të vitit paraardhës.

Cmimi i energjisë elektrike ka pësuar rritje prej 3 për qind krahasuar me vitin paraardhës. Importet e energjisë elektrike gjatë këtij tremujori janë reduktuar si në vëllim ashtu edhe në vlerë respektivisht me 16 dhe 14 për qind duke përfaqësuar vetëm 5.6 për qind të totalit të importit vendas.

Importet e karburantit gjatë këtij tremujori kanë shënuar një rritje të ndjeshme prej rreth 46.7 për qind prej së cilës vetëm 1.5 për qind i dedikohet rritjes si pasojë e kërkesës për karburante ndërsa 44.5 për qind vjen si rezultat i rritjes së cmimit të karburanteve. Pikërisht, karburantet e importuara gjatë tremujorit të parë të vitit 2008 u vlerësua 6.7 për qind e totalit të importeve.

Sipas një disagregimit në harmoni me sistemin e llogarive kombëtare, mallrat e ndërmjetëm zënë pothuajse gjysmën e importeve (49 për qind). Gjithashtu, nevoja e popullsisë për mallra konsumi ka rezultuar në rritje të importeve të kësaj kategorie duke përkeqësuar hendekun tregtar dhe si rezultat deficitin korent. Keto mallrat përfaqësojnë 36.4 për qind të totalit të importeve të vendit dhe janë vlerësuar me një rritje të ndjeshme prej 36.6 për qind. Mallrat kapitale përbëjnë rreth 15 për qind të totalit të importeve të vendit dhe kanë rezultuar në një rritje prej 26 për qind krahasuar me vitin paraardhës. Kontributi kryesor ndeshet në rritjen e importeve të makinerive dhe pajisjeve me rreth 22 për qind.

Ndikimi pozitiv i Marrevjeshjes së Stabilizim-Asocimit me BE ndjehet edhe në këtë tremujor në prirjet e theksuara të eksporteve drejt vendeve të Bashkimit Europian. Gjithashtu, prirje pozitive drejt eksporteve të vendit tonë është vënë re me hyrjen në fuqi të CEFTA-s në korrik të 2007-ës. Megjithatë, shpërndarja e eksporteve nuk është e njëtrajtshme, duke u përqëndruar në vendet fqinje, kryesisht Itali e Greqi të cilat zënë respektivisht 70 për qind dhe 9 për qind të eksporteve të përgjithshme.

Sikurse tremujorin e parë të vitit 2007, exportet e vendit tonë edhe gjatë këtij tremujori kanë shfaqur një shmangje drejt vendeve të rajonit. Për rrjedhojë, exportet drejt këtyre vendeve janë rritur me 25 për qind. Kjo rritje e eksporteve është përqëndruar kryesisht drejt Kosovës e cila zë 47 për qind të exporteteve totale të rajonit. Ky grupim rrit përfaqësimin në totalin e eksporteve duke zënë 10 për qind të eksporteve të Shqipërisë.

Partnerët dominues të importeve të vendit tonë mbeten Italia dhe Greqia edhe gjatë këtij tremujori. Për rrjedhojë, në vlerë reale importet që burojnë nga këto vende përbëjnë 320 milionë euro nga totali importeve, një rritje prej rreth 48 milionë euro krahasuar me vitin paraardhës.

Ndërkohë që në pjesën më të madhe të vendeve të BE importet vazhdojnë të rriten, vihet re një rënie e mallrave të importuara nga vendet e rajonit. Pjesën më të rëndësishme të importeve të këtij grupimi e përbëjnë importet nga Turqia të cilat kanë pësuar rënie prej 4 për qind gjatë këtij tremujori. E njëjta dukuri vërehet edhe për mallrat e importuara nga Serbia dhe Mali i Zi të cilat kanë pësuar një rënie të dukshme prej 90 për qind. Ndërkohë që flukset hyrëse të mallrave nga Maqedonia dhe Bullgaria kanë pësuar rritje 16 për qind dhe 13 për qind respektivisht.

Mallrat e importuara nga Kina mbeten me një rëndësi të vecante për importet e vendit tonë për vetë peshën që zënë ato në tregtinë e jashtme të Shqipërisë (7 për qind). Ritme të larta rritëse vlerësohen për flukset hyrëse nga Kina duke i rritur importet nga ky vend me 12 për qind krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2007.

I. 2. ZHVILLIMET NË ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE.

Transaksionet në shërbime regjistruan një vëllim prej rreth 621 milionë eurosh dhe vlerësohet 11 për qind më i lartë se një vit më parë, si pasojë e rritjes së njëkohëshme të eksportit dhe importit, përkatësisht me 12 dhe 11 për qind.

Tregtia në shërbime u mbyll me një bilanc negativ prej 30 milionë eurosh dhe vlerësohet në nivelet e tremujorit të parë të vitit 2007.

Shërbimet e udhëtimit edhe këtë fillim viti mbajnë peshën kryesore në tregtinë e shërbimeve. Eksporti dhe importi i shërbimeve të kësaj kategorie përfaqësojnë rreth 75 për qind të eksportit dhe 66 për qind të importit të të shërbimeve dhe vlerësohen me rritje kundrejt tremujorit të parë të vitit 2007 respektivisht me 10 dhe 14 pikë përqindje.

Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, eksporti i shërbimeve të udhëtimit ka sjellë 221 milionë euro të ardhura duke shënuar një rritje vjetore prej 30 për qind. Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së numrit të jorezidentëve (43 për qind) që kanë vizituar vendin, ku 55 për qind e të cilëve janë emigrantë. Gjithashtu, kjo rritje reflekton rritjen e çmimeve të mallrave dhe e shërbimeve të ofruara, duke ndikuar në rritjen e shpenzimeve gjatë udhëtimit në Shqipëri.

Ndërkohë, importi i tyre në formën e shpenzimeve të udhëtimit jashtë të rezidentëve Shqiptarë regjistron rreth 214 milionë euro. Ky vëllim vlerësohet rreth 21 për qind më i lartë krahasuar me tremujorin e parë të një viti më parë, si pasojë kjo e rritjes së numrit të udhëtarëve me 37 për qind si dhe në rritjes së shpenzimeve të tyre si pasojë e çmimeve të rritura në Europë, duke patur parasysh që, rezidentët udhëtojnë kryesisht në vendet e eurozonës.

Importi i transportit të mallrave është rritur pasi ka reflektuar natyrshëm rritjen e importit të tyre. Si pasojë, deficitin në shërbimet e transportit është 2-fishuar, në krahasim me një vit më parë.

Gjithashtu vihen re përmirësime në kategorinë e shërbimeve të komunikacionit, të atyre financiare dhe të biznesit.

Bilanci pozitiv i të ardhurave faktoriale në fund të periudhës (30.8 milionë euro) vlerësohet 42 për qind më i ulët se ai i tremujorit të parë të vitit 2007. Kjo rënie ka reflektuar në të dy kategoritë e të ardhurave; ato nga puna dhe nga investimet respektivisht me 52 dhe 36 për qind.

Të ardhurat nga investimet zënë rreth 58 për qind të bilancit pozitiv të të ardhurave dhe vlerësohen me një suficit prej 18 milionë euro. Fluksi i të ardhurave hyrëse përfaqësohet kryesisht nga interesat e përfuara nga rezervat valutore të sistemit bankar kurse fluksi dalës përfaqësohet kryesisht nga interesat e borxhit të jashtëm.

Shqipëria gjatë tremujorit të parë të këtij viti ka paguar 3.4 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm të cilat vlerësohen lehtësisht me një rritje të lehtë (0.2 milionë euro) kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë.

Transferta korente edhe këtë tremujor përfaqësohen kryesisht nga dërgesat emigrantëve në familjet e tyre. Këtë tremujor, këto të fundit regjistrojnë rreth 219 milionë euro dhe vlerësohen të kenë financuar deficitin tregtar në mallra në masën 41 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë këto transferta vlerësohen 5 për qind më të ulëta pasi vihet re një zhvendosje të këtyre flukseve valutore nga ato për përdorim korrent në formën e investimeve. Transferta nga emigrantët janë shoqëruar edhe nga transferta të tjera private dhe shtetërore, respektivisht me 16 dhe 6 milionë euro.

II. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Lëvizjet e kapitalit, gjatë këtij tremujori, rezultuan në një fluks neto prej rreth 218 milionë euro, duke mundësuar financimin e deficitit korent me rreth 75 për qind. Transferta kapitale shënojnë rreth 13 milionë euro dhe karakterizohen kryesisht nga grante me karakter investimi si në sektorin shtetëror ashtu edhe në atë privat.

Llogaria financiare vlerësohet me një bilanc pozitiv prej rreth 205 milionë euro dhe vlerësohet 35 për qind më i lartë se fillimviti 2007. Ekonomia shqiptare

ka rritur si detyrimet ashtu edhe mjetet financiare respektivisht me 228.6 dhe 23.6 milionë euro.

Rritja e detyrimeve financiare këtë tremujor i dedikohet kryesisht flukseve hyrëse të kapitalit në formën e investimeve të huaja direkte, si dhe investimeve të tjera në formën e investimeve afatshkurtra në sektorin bankar si dhe huamarrjes afatgjatë të sektorit shtetëror.

Fluksi i investimeve të huaja direkte regjistroi rreth 119 milionë euro. Duhet përmendur që këtë fillim viti, kanë qenë flukset hyrëse të kapitalit në sektorin financiar, ato të komunikacionit që kanë luajtur rolin kryesor në këto investime pasuar nga industria përpunuese.

Lëvrimet e kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë, të cilat mbeten një faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj botës, gjatë këtij viti vlerësohen 20.3 milionë euro nga të cilat 81 për qind kanë shkuar për sektorin e qeverisë dhe atë publik të garantuar. Kjo rritje ka financuar kryesisht investimet në infrastrukturë, e reflektuar kjo edhe në rritjen e importeve mallra kapitale. Ndërkohë, huamarrja private duket të ketë ngadalësuar ritmet e rritjes së saj dhe vlerësohet 3.8 milionë euro.

Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit dhe të interesit vlerësohen në rreth 12.9 milionë euro, të barasvlefshme me 6.2 për qind të eksportit të mallrave gjë që tregon për një aftësi paguese brenda niveleve të pranuar.

Rritja e mjeteve financiare këtë tremujor vjen plotësisht nga investimet afatshkurtra te sistemit bankar ne institucionet financiare jorezidente. Vihet re ndryshim i raportit të mjeteve të investimit. Mjetet në formën e investimeve të portofolit janë zhvendosur në investime të rezervave të sistemit bankar në tregun ndërkombëtar në formën e depozitave dhe huave afatshkurtra. Këtë fillim viti rritja e ketyre mjeteve vlerësohet 30 milionë euro.

Mjetet e rezervave të Autoritetit Monetar kanë rënë me 25.7 milionë euro. Në fund të tremujorit të parë 2008 këto rezerva regjistruan nivelin 1.41 miliardë euro, të mjaftueshme për të mbuluar rreth 3.3 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Tabelë 1. Bilanci i Pagesave (në milionë euro).

	T-1 2007	T-2 2007	T-3 2007	T-4 2007	T-1 2008
Llogaria korente	-176.5	-187.3	-170.0	-297.6	-289.3
Eksporti i mallrave	182.3	209.8	197.3	196.9	205.2
Importi i mallrave	-625.1	-710.5	-724.7	-830.1	-736.5
Bilanci tregtar	-442.7	-500.6	-527.4	-633.3	-531.3
Shërbimet: kredi	265.1	337.5	454.3	358.3	295.8
Shërbimet: debi	-292.7	-324.1	-443.1	-342.5	-325.5
Të ardhurat: kredi	62.0	56.6	95.0	65.0	43.2
Të ardhurat: debi	-8.7	-13.1	-20.6	-19.4	-12.4
Transferta private pa shpërblim	223.8	244.9	254.7	259.3	235.0
Transferta shtetërore pa shpërblim	16.6	11.6	17.0	14.9	6.0
Llogaria kapitale	26.9	16.5	21.8	24.9	13.0
Llogaria financiare	151.8	142.4	276.2	169.7	205.0
Investime direkte	91.4	55.9	223.1	95.2	124.7
Investime portofoli	18.5	0.0	-19.2	19.2	1.4
Kapitale të tjera*	39.1	86.6	69.6	55.3	81.9
Gabime dhe harresa neto	12.3	51.4	7.1	79.0	45.6
Bilanci i përgjithshëm	14.5	23.1	135.1	-24.1	-25.7
Mjetet e rezervës	-14.5	-23.1	-135.1	24.1	25.7
Përdorim huash e kredish nga FMN	2.8	0.0	2.7	0.0	-2.9
Ndryshimi total në rezerva nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	13.3	13.4	120.0	-47.7	-54.6
	-1.2	-9.6	-15.1	-23.6	-29.0

* Nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.

Burimi: Banka e Shqipërisë.